


RRETH NESH

Kur bëhet fjalë për bojra për shtëpinë apo biznesin tuaj ne kemi vendosur standartin e përsosmërisë. Ndërtuar në vitin 2015, bojërat Pinto Color janë bojëra me lëndë të para ekologjike me një performancë të pakrahasueshme. Nga ana tjetër ne ofrojmë një shumëllojshmëri ngjyrash që përmbushin imagjinatën tuaj.

Me një laborator të pajisur me pajisjet më të avancuara e teknologjinë më moderne në Ballkan, ne sjellim gjithmonë produktet më cilësore për klientët tanë. Një gamë e gjerë produktesh e cila përmbush çdo nevojë të tregut vendas e më gjerë.



AQUA



SCAN ME

CONTACT:

Numër Telefoni

069 606 6656

E-Mail

info@dekoll.al

Website

www.dekoll.al

Na vizitoni në rrjetet sociale ku mund të mesoni më shumë rreth produkteve tona dhe të zbuloni gamën e produkteve PINTO COLOR.



PINTOCOLOR®
TUTTI I MIEI COLORI



PRODUKTE ME BAZË UJI

Zbuloni bukurinë e produkteve të bojës me bazë uji, ku inovacioni takohet me efektin ekologjik. Ato vijnë në një sërë ngjyrash dhe përfundimesh mahnitëse, duke ju lejuar të nxirrni kreativitetin tuaj dhe duke kontribuar në një të ardhme të qëndrueshme.

JEPINI NGJYRË IMAGJINATËS



AQUAPINTO DECOR

Produkt dekorues dhe antimol me ngjyre, i pershtatshem per aplikim per cdo siperfaqe druri te brendshme dhe te jashtme. Me baze uji dhe depertim ne thellesi te drurit. Ideal per parandalimin e rritjes se baktereve dhe te kerpudhave ne shtresen e drurit. I pershtatshem per aplikim ne siperfaqe druri vecanerisht per siperfaqe ne ambientet e brendshme qe ju mungon ajrimi i pershtatshem. Ka rezistence jashtezakonisht te larte nga kushtet atmosferike te veshtira, nga rrezet e diellit, nga lageshtia dhe ngrica. Jep nje pamje satine e cila rrit bukurine natyrale te drurit.

AQUAPINTO PRIMER

Është një astar i bardhë ekologjike me bazë uji, ideal për sipërfaqet e brendshme dhe të jashtme te drurit. Shfaq ngjitje të fortë në sipërfaqet e lyera me ngjyra smalto me bazë tretës. Për shkak të formulës së tij të veçantë mbron përdoruesin dhe nuk ndot mjedisin. Nuk përmban substanca të rrezikshme, si metale të rënda, formaldehid të lirë, hidrokarbure aromatike. Ka punueshmeri te mire dhe mbulim te larte.

AQUAPINTO VARNISH

Llak mbrojtës për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm. I jep drurit një pamje të bukur me shkëlqim e cila nuk do zverdhet me kalimin e kohës. Kjo shtresë fiton rezistencë ndaj shiut që pas orës se parë të aplikimit. Ofron mbrojtje afatgjatë, pa aromë dhe miqësore me ambientin. Veshje finale transparente e cila thahet në 30 minuta.



AQUAPINTO ZMALTO

Është bojë ekologjike me bazë uji e cilësisë premium, për sipërfaqe druri. Është ideal për të gjitha zonat e banuara të brendshme dhe të jashtme. Për shkak të formulës së saj të veçantë, mbron përdoruesin dhe nuk ndot mjedisin. Nuk përmban substanca të rrezikshme, si metale të rënda, formaldehid të lirë, hidrokarbure aromatike. Ka bardhësi të madhe dhe nuk zverdhet me kalimin e kohës. Ka veti të shkëlqyera punuese dhe niveluese dhe ka elasticitet të madh. Ka mbulueshmëri shumë të mirë, hapje të lartë dhe lë një sipërfaqe finale të lëmuar. Disponohet me shkëlqim dhe satine.

PËRZIJENI MIRË PARA PËRDORIMIT
MBROJENI NGA NGRICAT
MOS APLIKONI NË TEMPERATURA NËN 10°C.